

Falenderimi i takon Allahut, ndërsa begatia dhe mëshira e tij qoftë për profetin Muhamed dhe pasuesit e tij.

Ashura është dita e dhjetë e muajit Muharrem, një nga katër muajt e shenjtë gjatë të cilit jemi urdhëruar që të qëndrojmë larg gjynaheve dhe padrejtësisë. Gjithashtu në këtë muaj është mjaft i pëlqyer agjërimi.

Profeti (alejhi salatu ue selam) ka thënë: **“Agjërimi më me vlerë pas agjërimit të muajit të Ramazanit është ai i muajit Muharrem.”** (Muslimi)

Dita e Ashurës është nga ditët më me vlerë të vitit dhe agjërimi i kësaj dite është mjaft i pëlqyer.

Ibn Abasi (radijallahu anhumu) ka thënë: **“Nuk e kam parë Profetin (alejhi salatu ue selam) që synonte agjërimin e një dite me vlerë, se sa Dita e Ashuras dhe muajin e Ramazanit.”** (Buhariu)

Vlera e ditës së Ashures

Agjërimi i kësaj dite fal mëkatet e një viti të plotë.

Profeti (alejhi salatu ue selam) ka thënë: **“Agjërimi i Ditës së Ashures, shpresoj që Allahu të më falë gjynahet e vitit që kaloi.”** (Muslimi)

Agjërimi i Ditës së Ashurës ka qenë i ligjëruar edhe tek popujt para nesh

Profeti (alejhi salatu ue selam) kur erdhi në Medine shikoi çifutët që agjëronin në këtë ditë dhe tha: **“Kjo është një ditë e mirë. Në këtë ditë Allahu shpëtoi Beni Israilët nga armiku i tyre, prandaj Musai agjëronte këtë ditë. Mua më takon që ta agjëroj më shumë se sa ju.** Prandaj Profeti (alejhi salatu ue selam) agjëronte këtë ditë dhe urdhëroi agjërimin e saj.” (Buhariu)

Kurse në transmetimin e Muslimit thuhet: **“Kjo është një ditë e madhe, në të cilën Allahu shpëtoi Musain e popullin e tij dhe fundosi Faraonin dhe popullin e tij, për këtë arsye agjëronte Musai si falenderim ndaj Allahut, prandaj edhe ne e agjërojmë.”**

Pëlqehet të agjërohet edhe një ditë para saj

Kur Profeti (alejhi salatu ue selam) e agjëronte Ditën e Ashurës i treguan se kjo është një ditë që e madhërojnë çifutët dhe të krishterët. Profeti (alejhi salatu ue selam) tha: **“Vitin që vjen, do të agjërojmë edhe ditën e nëntë në dashtë Allahu.** Kur erdhi viti tjetër Profeti (alejhi saltu ue selam) kishte ndërruar jetë.” (Muslimi)

Pra, kishte për qëllim të mos iu ngjasonte atyre në këtë adhurim, duke agjëruar edhe ditën e nëntë.

Bidatet e Ashuras

Është pyetur Shejhul Islam Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë) për veprimet që bëjnë njerëzit këtë

ditë, siç është: Larja e të gjithë trupit, përshëndetja me dhënien e dorës, gatimi i grurit, shfaqja e gëzimit, etj.

Ai është përgjigjur: Falenderimi i takon Allahut për gjithçka. Nuk është transnetuar asnjë hadith i saktë në lidhje me këto veprime dhe të tjera si këto, as nga shokët e tij, as nga tabi-inët apo katër imamët e medh-hebeve. Gjithashtu ka përmendur edhe bidatet e shijave të cilët këtë ditë e konsiderojnë si ditë mërzie, vajtimi duke grisur rrobat dhe duke goditur veten. Dhe për këta thotë: E keqja dhe sherri që sjellin këta njerëz për fenë islame nuk i numëron dot as oratori më mirë.

E mbyll fjalën e tij duke thënë: Një grup e konsiderojnë këtë ditë si feste dhe ditë gëzimi, kurse të tjerët e shfaqin si ditë mërzie dhe zemërimi dhe të dyja grupet janë jashtë traditës profetike.

Pra, në këtë ditë nuk veprohet asgjë e veçantë përveç agjërimit.

Allahu na forcoftë në fenë islame dhe na bëftë pasues të denjë të traditës profetike. Amin!

Hoxhë Irfan TOTA